

VENDIM
Nr.8, datë 21.3.2006

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE NR.1, DATË 22.12.2004
“PËR LISTËN E DOKUMENTEVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE
DHE PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”**

Në mbështetje të shkronjave “i” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, me propozim të Drejtorisë së Analizës Financiare dhe Aktuaristikës, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1.Të miratojë udhëzimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Të njoftohen të gjitha shoqëritë e sigurimit për këto ndryshime.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera**